

Arsim Canolli

FLIJA: NJË VËSHTRIM ETNOGRAFIK,

Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike (2018, ISBN 978-9928289001)

Botimeve në lëmin e antropologjisë social-kulturore në gjuhën shqipe i është shtuar një studim solid në gjininë e kulturës buknore. Është fjala për monografinë *Flija: Një vështrim etnografik* nga Arsim Canolli. Studimi është ndërtuar duke u përqendruar mbi flinë, pra një gatesë dhe, që këtu, ftesa është për të braktisur shtegun e temave të mëdha. Është kalimi i kurthit të parë teorik e historik, gjë e cila ndodh rrallë për një traditë etnografike, dominuar nga njëfarë prirje monumentalizmi dhe, jo rrallë, edhe populizmi. Duke vëzhguar e qëmtuar gjithë jetën sociale dhe kulturore, botën shqisore dhe afektive që krijon ideja, praktika, vetë procesi i shijimit të flisë, gradualisht lexuesit i paraqitet një etnografi me shumë pore, një etnografi e ndërvarur prej *gjeografisë së shijes*, që dëshmon rëndësinë e studimit etnografik. Tregim etnografik që nuk

vetëmbyllet, por vazhdimisht parashtron, analizon, ripropozon.

Argumenti antropologjik shtrihet pastaj në sfondin e antropologjisë shqisore, identitare, religjioze dhe, dalëngadalë, duket sikur "flija" merr trajtën e një fakti social total. Por, në fakt, arrihet të realizohet një rrugëtim etnografik mjaft i rëndësishëm, që ka të bëjë me përshkrimin e thukët antropologjik të dukurisë kulturore marrë në analizë. Vëmendja etnografike e autorit konsiston në shqyrtimin se si gjallon një praktikë, si përjetohet, si transmetohet, negociohet, si kujdesen njerëzit për ta përcjellë si dije dhe si traditë, si e artikulojnë apo ri-artikulojnë ata në kohën e tyre, turistifikimi i një gatese, por edhe i gjuhës përreth e mbi të, kuptimin e saj kulturor atëherë e "ktynehere", kuptimet e kujtimet individuale dhe familjare, si lidhet me territoret e përmalljes, me territoret e përballjes në të

tashmen, e njëfarë loje se si njerëzit e shohin atë në rendet kohore. Pra, flija, si topos etnografik, herë merr socialen e mat kuptimet e saj e herë bëhet vendi ku sociabiliteti e kulturorja maten. Mastarët janë kohorë dhe hapësinorë, prej brenda dhe jashtë, atëherë dhe sot, prej zjarrit te dielli.

Pra, flija, më shumë ç'rrjedh prej traditës dhe asaj që e rrethon, del si një gatesë, e cila rrethohet nga një tis i magjepsjes tradicionale, duke u mveshur me kuptime të reja, që lidhen tashmë me dëshirën dhe nevojën, emocionet e njeriut në një shoqëri që ia ka dalë të jetë e lirë, një shoqëri që po ndërton shtetin e saj, por edhe një shoqëri që po ndërton narrativa të reja në çdo cep së saj. Canolli, me shumë kujdes, bën çmos dhe ia del mbanë të ruajë dialogun me shumë vështrime teorike, duke mos u ancoruar në portin e një teorie dhe, prej këtu, t'i shërbejë asaj, por duke ndjekur shtegun klasik dhe idealin e kryeherës të së tashmes antropologjike. Canolli ruan me dinjitet pozicionin e antropologut duke parashtruar pyetje, por edhe duke i ndërvarur prej lëndës empirike. Për

shembull, një nga teoritë që testohet nëpërmjet etnografisë së flisë është ajo e “shpikjes së traditës”, apo qasjet “stambollocentriste” siç i quan Canolli, qasje të cilat ose e vendosin çdo traditë në kushtin e sajimit apo shpikjes intelektuale, ose i shqyrtojnë si qasje në emër të kritikës ndaj esencializmave prejardhur prej nacionalizmit apo europianocentrizmit dhe që fillojnë e ushqejnë një centrizëm tjetër siç është rizbulimi i qendrave perandorake, si qendra e rrethit origjinar kulturor. Në fakt, vetë tema e përzgjedhur është një vënie në lojë e shumë centrizmave institucionale e kulturorë.

Etnografikisht Canolli ka ndjekur dy qasje. Punën e parë e ka realizuar nëpërmjet një etnografie *pas dyerve të hapura* të restorantit, si të përkundërt me etnografinë *përtej mureve të ngurta*. Mbi këtë punë ka realizuar jo vetëm mbrojtjen e doktoraturës në University College London, por edhe ka krijuar bazën e shqyrtimit etnografik të temave specifike siç është kultura buknore dhe vetë trajtimi i flisë në vrojtim etnografik. Herë pas here, zbret e merr inkursione nëpër periudha historike, por nuk heziton të

shprehë drojën ndaj burimeve historike dhe historicizmit. Pra, kemi një ndërthurje në mes etnografisë së të tashmes (prezentiste) dhe asaj historiciste në terma të *longue durée*. Po ashtu, kemi një etnografi, e cila përcakton qartë territorin e saj në një vend, por edhe atë që aplikohet me anë të vizitave kërkimore.

Pasi ka bërë të gjitha këto qëmtime etnografike, duke prekur çdo skaj që ka mundur të rrokë leximi etnografik, Canolli parashtron teza të ndryshme leximore, duke propozuar shqyrtime e ftesa të tjera që lidhen me trashëgiminë kulturore, mbi kulturën si relikte, mbi kulturën e parë me bazë tek arkaikja, te kultura në raportet krijuese dhe asaj mimetike. Pa rënë në esencializime, pa lëshuar nga stili i hollë dhe komunikues, Canolli krijon një tekst etnografik që fton lexuesin të shohë nëse kemi të bëjmë me një kulturë që është duke u bazuar te mimikimi apo jo. Nëse po, si; nëse jo, pse jo. Po flija, po përshtatja e saj me kohën, po rezistenca për të ruajtur kulturën e gatimit të saj si dikur, po kultura buknore në tërësi, po kultura në tërësi? Në fakt, tek

librit fillon t'i shfaqet fundi, del qartë se autori nuk është duke mbyllur një analizë, por është duke hapur shtigje reflektimi mbi kulturën dhe shoqërinë në tërësi, ku teza më kryesore, në vështrimin tonë, është shqyrtimi i raportit në mes kulturave që imitojnë dhe kulturave që lëshohen në reflektim e kërkojnë bazën e tyre te kreativiteti. Me hapjen e këtij shtegu, apo thjeshtë lëshimit të konstatimeve në fund të analizës, autori shënon edhe mbylljen e një diskutimi, duke e rihapur në dimensionë të tjera.

Është me rëndësi të nënvizojmë edhe një fakt tjetër: stilin e shkrimit antropologjik. Canolli dëshmon edhe me këtë monografi për një prozë poetike antropologjike. Një stil i tillë krijon kushtin që lexuesi të gjendet para një rrëfimi etnografik me plot nuanca, duke begatuar interpretimin dhe analizën antropologjike. Këtij stili i bëhet krahu një fjalor i pasur analitik, përshkrimor e stilizues, duke u bërë mjeti i kumtit antropologjik. Kjo është një cilësi shtesë që mbart ky kontribut - si të tjerë të ardhur nga Canolli - dhe që i bëjnë nder letrave shqipe. Duke pasur parasysh këto, monografia *Flija*:

Vrojtim etnogafik, vjen si model i një etnografie jo-monumentale, në thelb dialogjike që ka horizont debatin botëror në antropologji teksa lëvron një antropologji në dheun e vet. Si e tillë, kjo vepër

mbart në tharmin e saj aftësinë për t'u ripërtërirë vazhdimisht në dialogun antropologjik. Prandaj ajo meriton të vendoset ndër veprat më të mira në lëmin e antropologjisë social-kulturore.

Nebi Bardhoshi

Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit